

AUTORIZIM ZYRTAR

Nr. 5, datë 13.4.2001

PËR TË VEPRUAR SI SHOQËRI SIGURIMI

Në mbështetje të ligjit nr.8081, datë 7.3.1996 “Për veprimtaritë e sigurimit dhe /ose risigurimit” të ligjit nr.8606, datë 27.4.2000 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8081, datë 7.3.1996 “Për veprimtaritë e sigurimit dhe /ose risigurimit, ndryshuar në ligjin nr.8458, datë 11.02.1999”, si dhe të akteve të tjera nënligjore që rregullojnë veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit.

KOMISIONI I MBIKQYRJES SË SIGURIMEVE AUTORIZON:

Shoqërinë Anonime “ATLANTIK” sh.a. me seli në Tiranë, e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë me nr. Akti 25720, të kryejë sigurime për dëmet, në përputhje me lejen për ushtrim aktiviteti.

LEJE PËR FILLIMIN E USHTRIMIT TË AKTIVITETIT TË SIGURIMEVE DHE/OSE RISIGURIMEVE

Shoqëria e sigurimit “ATLANTIK” sh.a., e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë me nr. Akti 25720, me seli në Tiranë në adresën :”DORO CENTER, Rruga Muhamet Gjolllesha”, lejohet të fillojë kryerjen e operacioneve të sigurimit në grupet e sigurimit, siç janë listuar më poshtë.

Në mbështetje të pikës A të shtojcës së ligjit nr.8081, datë 7.3.1996 “Për veprimtaritë e sigurimit dhe /ose risigurimit”, grupet e sigurimit do të jenë si më poshtë:

1. Grupi nr 1 “Aksidente”
2. Grupi nr 2 “Sëmundjet”
3. Grupi nr 3 “Mjete tokësore (të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina)”
4. Grupi nr 6 “Anijet”
5. Grupi nr 7 “Mallrat në transport (përfshirë mallra, bagazhe dhe të gjitha llojet e tjera të sendeve)”
6. Grupi nr 8 “Zjarri dhe forcat e natyrës”
7. Grupi nr 9 “Dëmtime të tjera të pasurisë”
8. Grupi nr 10 “Përgjegjësitë civile nga përdorimi i automjeteve”
9. Grupi nr 13 “Përgjegjësitë civile të përgjithshme”
10. Grupi nr 15 “Garancitë”

Kjo leje për ushtrim aktiviteti është pjesë përbërëse dhe i bashkangjitet autorizimit zyrtar nr.5, datë 13.4.2001.

U lëshua sot në Tiranë, më datë 01.06.2001 nga KOMISIONI I MBIKQYRJES SË SIGURIMEVE.

**KRYETARI
Vangjel Birbo**